



Republika e Maqedonisë së Veriut
Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore

VERSIONI I KONSOLIDUAR

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E TITUJVE PROFESIONALË DHE SHKENCORË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

I.1. Çështje të përcaktuara

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen titujt profesionalë dhe shkencorë që studentët fitojnë pas përfundimit të programit **studimor** të ciklit të parë, të dytë ose të tretë.

I.2. Qëllimi

Neni 2

Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë elementët që përbëjnë titujt profesionalë dhe shkencorë që fitohen pas përfundimit të **programit studimor** të akredituar të ciklit të parë, të dytë ose të tretë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke i mundësuar personit që i ka përfunduar ata, të kryejë një aktivitet profesional ose të vazhdojë studimet.

Neni 3

(1) Në titullin akademik (titulli shkencor dhe artistik) dhe titullin profesional përcaktohet shkalla dhe lloji i arsimit të fituar në institucionin e arsimit të lartë sipas **programit studimor** të ciklit të parë, të dytë ose të tretë.

(2) Titullin akademik e fiton secili që përfundon **programin studimor** për përfundimin e arsimit të lartë nga cikli i parë ose të dytë i studimeve akademike.

(3) Titullin profesional e fiton secili që përfundon **programin studimor** për përfundimin e arsimit të lartë nga cikli i parë ose të dytë i **studimeve profesionale**.

(4) Titullin shkencor e fiton secili që përfundon **programin studimor** për përfundimin e arsimit të lartë nga cikli i tretë.

II. MËNYRA E **KRIJIMIT/FORMIMIT** TË TITUJVE PROFESIONALË DHE SHKENCORË

Neni 4

(mënyra e krijimit të titujve sipas **programeve studimore** të ciklit të parë)

(1) Pas përfundimit të studimeve akademike deridiplomike (cikli i parë i studimeve akademike) me 180 **ECTS** ose 240 **ECTS**, studenti fiton titullin akademik - „i diplomuar“ **duke shtuar shënimin që del nga programi studimor dhe theksuar numrin e ECTS.**

(2) Pavarësisht nga paragrafi i parë i këtij **neni**, pas përfundimit të studimeve akademike deridiplomike (cikli i parë i studimeve akademike) nga fusha e shkencave teknike, teknologjike, **bujqësore, pyjore** dhe të ngjashme, me 180 **ECTS** ose 240 **ECTS**, studenti fiton titullin akademik - „inxhinier i diplomuar“ **duke shtuar shënimin që del nga programi studimor dhe theksuar numrin e ECTS. Shenja e dalë nga programi studimor mund të shkruhet edhe në mes të fjalëve „i diplomuar“ dhe „inxhinier“.**

(3) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze, titulli akademik pas përfundimit të studimeve deridiplomike (cikli i parë i studimeve akademike) është Bachelor of Science **ose** Bachelor of Arts, **duke shtuar shënimin që del nga programi studimor.** Numri i **ECTS** shtohet në kllapa.

(4) Pas përfundimit të studimeve profesionale deridiplomike (cikli i parë i studimeve profesionale) prej 180 ECTS, studenti fiton titullin profesional - „specialist i lartë“ me shtimin e fushës së specializimit. Pas përfundimit të studimeve të shkurtuara deridiplomike profesionale (cikli i parë i studimeve profesionale) me 60 deri në 120 ECTS, studenti fiton titullin profesional - „specialist i lartë“ me shtimin e fushës së specializimit.

(5) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze, titulli profesional pas përfundimit të studimeve universitare (cikli i parë i studimeve profesionale) është Bachelor of Applied Science ose Bachelor of Applied Arts, me shtimin e profesionit. Numri i ECTS shtohet në kllapa.

Neni 5

(mënyra e krijimit të titujve sipas programeve studimore të ciklit të dytë)

(1) Pas përfundimit të studimeve akademike pasdiplomike (cikli i dytë i studimeve akademike) ose studimeve të integruara deridiplomike dhe pasdiplomike (cikli i parë i integruar me ciklin e dytë të studimeve akademike), studenti fiton titullin akademik Magjistër i shkencave ose Magjistër i arteve me shënim të fushës ose nën-fushës shkencore. Shënimi i fushës ose nën-fushës shkencore nxirret nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Fraskatit i vitit 2015 dhe shkruhet në mes të fjalëve „magjistër“ dhe „shkenca“, përkatësisht „magjistër“ dhe „artet“. Shënimi i dalë nga fusha ose nën-fusha shkencore mund të shkruhet edhe pas fjalëve „Magjistër i shkencave“ ose „Magjistër i arteve“. Titulli plotësohet me përcaktimin e fushës/sferës përkatëse.

(2) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze, titulli akademik pas përfundimit të studimeve pasdiplomike (cikli i dytë i studimeve akademike) është Master of Science ose Master of Arts, në fushën/sferën përkatëse.

(3) Pavarësisht paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, pas përfundimit të studimeve të integruara akademike deridiplomike dhe pasdiplomike (ciklin e parë të integruar me ciklin e dytë të studimeve akademike) të programeve studimore të Mjekësisë, Mjekësisë Dentare, Veterinarisë, Farmacisë dhe Arkitekturës, studenti fiton titujt akademikë të mëposhtëm:

- me përfundimin e programit studimor të integruar në Mjekësi: Doktor i Mjekësisë (Doctor of Medicine);
- me përfundimin e programit studimor të integruar në Mjekësi Dentare: Doktor i Mjekësisë Dentare (Doctor of Dental Medicine);
- me përfundimin e programit studimor të integruar në Mjekësi Veterinare: Doktor i Mjekësisë Veterinare (Doctor of Veterinary Medicine);
- me përfundimin e programit studimor të integruar në Farmaci: Magjistër i Farmacisë (Master of Pharmacy);
- me përfundimin e programit studimor të integruar në Arkitekturë: Magjistër Inxhinier i Arkitekturës (Master Engineer in Architecture).

(4) Pas përfundimit të studimeve profesionale pasdiplomike (cikli i dytë i studimeve profesionale), studenti fiton titullin profesional - „specialist“ me shtimin e fushës së specializimit.

(5) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze, titulli profesional pas përfundimit të studimeve pasuniversitare (cikli i dytë i studimeve profesionale) është Specialist Applied me shtimin e fushës së specializimit.

Neni 6

(mënyra e krijimit të titujve sipas programeve studimore të ciklit të tretë)

(1) Pas përfundimit të studimeve të doktoraturës (cikli i tretë i studimeve akademike) studenti fiton titullin shkencor Doktor i shkencave ose Doktor i arteve me shënim të fushës ose nën-fushës shkencore. Shënimi i fushës ose nën-fushës shkencore nxirret nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Fraskatit i vitit 2015 dhe shkruhet në mes të fjalëve „doktor“ dhe „shkenca“, përkatësisht „doktor“ dhe „artet“. Shënimi i dalë nga fusha ose nën-fusha shkencore mund të shkruhet edhe pas fjalëve „Doktor i shkencave“ ose „Doktor i arteve“. Titulli plotësohet me përcaktimin e fushës/sferës përkatëse.

(2) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze titulli akademik pas përfundimit të studimeve të doktoraturës është Doctor of Science ose Doctor of Arts, Doctor of Philosophy.

Neni 7 **(shkurtesat)**

(1) Në programet studimore, përveç titullit të plotë akademik (shkencor ose artistik) dhe titullit profesional, përcaktohet edhe shkurtesa e tij.

(2) Për titujt akademikë në programeve studimore të ciklit të parë të studimeve akademike që përmbajnë termin:

- „i diplomuar“ përdoret shkurtesa „dipl.“;

- „i diplomuar inxhinier“ shkurtesa „dipl. inxh“, domethënë „inxhinier i diplomuar ...“ shkurtesa „dipl. inxh. ...“;

(3) Për titujt akademikë nga programet studimore të ciklit të dytë që përmbajnë termin „magjistër“ përdoret shkurtesa „mr.“;

(4) Për titujt akademikë nga programet studimore të programeve studimore të integruara universitare të ciklit të parë dhe të dytë që përmbajnë termin:

- „Doktor i Mjekësisë“, „Doktor i Mjekësisë Dentare“ dhe „Doktor i Mjekësisë Veterinare“ përdoret shkurtesa „dr.“;

- „Magjistër i Farmacisë“ përdoret shkurtesa „mr. farm.“;

- „Magjistër Inxhinier i Arkitekturës“ shkurtesa „mr. inxh. ark.“.

(5) Për programet studimore të ciklit të tretë, për titullin shkencor „Doktor i shkencave“ dhe „Doktor i arteve“, përdoret shkurtesa „dr.“.

Neni 8

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/2021), Rregullorja për metodologjinë, standardet dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për akreditimin e programeve studimore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 256/2022), Rregullorja për përmbajtjen e programeve studimore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 79/2023), Rregullorja për standardet dhe normat për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarive të arsimit të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 245/2022), Rregullorja për standardet dhe normat për themelimin e instituteve shkencore dhe për kryerjen e veprimtarive kërkimore-shkencore të cilët i referohen programeve studimore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 245/2022) dhe Rregullorja për përmbajtjen dhe formën e diplomës, udhëzimet për përgatitjen e shtojcës së diplomës dhe dokumenteve tjera publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 102/2018).

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, dispozitat e saj zbatohen detyrimisht gjatë dorëzimit të **Elaborateve** të reja për akreditimin e programeve studimore të ciklit të parë, dytë dhe të tretë të studimeve akademike ose profesionale **deri te Bordi për Akreditim** pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetar
i Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë
dhe Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore

проф. д-р Гордана Лажетик